



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 25.09.19 Ref.: 1786/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 77-të të mbajtur më 16.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet pjesërisht kërkesa e Kolegjit "ISPE" Nr. 1136/19H, datë 03.07.2019 për riakreditim të programeve të studimit:

- Ekonomi, BA 180 ECTS
- Studime të Integruara Evropiane, BA 180 ECTS
- Studime Evropiane, MA, 120 ECTS
- Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS
- Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

1/2

Arsyetim

I. Kolegji ISPE ka parashtruar kërkesë (kërkesa Nr. 1136/19H, datë 03.07.2019) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit: 1. Ekonomi, BA, 180 ECTS, 2. Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS, 3. Studime Evropiane, MA, 120 ECTS, 4. Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, 5. Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018 (tash e tutje UA për Akreditim), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur me 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit ISPE.

Bazuar në pikën 1.2 të Neni 10 të UA për Akreditim, thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së",* KShC erdhi në përfundim se programet e sipër përmendura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me aktet ligjore në fuqi.

Bazuar në Nenin e referuar më lartë, KShC në mbledhjen e mbajtur më 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Kolegj. Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programin me të cilin ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar nga ky institucion për stafin akademik, në mungesë të Lejeqëndrimit valid për stafin akademik me shtetësi të huaj, ashtu siç parashihet me Nenin 30, pika 5 e UA për Akreditim, KShC mori vendim për refuzim të aprovimit të aplikacionit për programet e përmendura në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit Ekonomi, BA, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji ka paraparë: Petrit Perhati, Ndrçim Çiroka dhe Sazan Guri. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se të tre këta persona kanë Lejeqëndrim të skaduar.

Për programin e studimit Studime të Integruara Evropiane, BA, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji ka paraparë: Avni Mazrreku, Lulzim Hoxha, Rifat Demalija, Fatbardha Shpati. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se Lulzim Hoxha, Rifat Demalija dhe Fatbardha Shpati kanë Lejeqëndrim të skaduar.

Për programin e studimit Studime Evropiane, MA, 120 ECTS, si bartës i këtij programi Kolegji ka paraparë: Aleksandër Muskaj, Shkëndi Çili, Klementina Ngjeçi. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se të tre këta persona kanë Lejeqëndrim të skaduar.

Për programin e studimit Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji ka paraparë: Gjon Culaj, Bajram Ibraj, Oreta Saliaj, Krenar Ahmeti. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se deklarata e angazhimit e z. Gjon Culaj është e vitit akademik 2017/2018. Ndërsa që Oreta Saliaj dhe Krenar Ahmeti kane Lejeqëndrim të skaduar.

Për programin e studimit Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS, si bartës i këtij programi Kolegji ka paraparë: Donila Pipa, Iris Menga, Shkëlçim Sirika dhe Alfred Halilaj. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se të katër këta persona kanë Lejeqëndrim të skaduar.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit ISPE
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë